

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7024
E mërkurë, 18 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Osmani nuk dekreton Blerim Isufajn në pozitën e Kryeprokuroorit të Shtetit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE LIRON NGA BURGU HYSNI GUCATIN | FAQE 4-5

HYSNI GUCATI KTHEHET NË KOSOVË, PRITET NGA FAMILJARËT DHE BASHKËLUFTËTARËT



Dhomat e Specializuara në Hagë njoftuan se kanë modifikuar dënimin ndaj ish-kreut të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati, duke i mundur atij lirin nga burgu me disa kushte. Sipas njoftimit të Speciales, kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, konstatoi se Gucati kishte reflektuar për veprimet e tij gjatë qëndrimit në objektin e paraburgimit në Hagë dhe "sjellja e tij kishte ndryshuar me kalimin e kohës"

AKTUALE



VRASJET NË FRANCË DHE
BELGIKË, FRIKË PËR SIGURINË NË
EVROPË. GJERMANIA, NË ALARM | F. 2

BE-ja KONFIRMON VIZITËN E
PESËSHES NË KOSOVË DHE SERBI,
KËRKON PËRPARIM KONKRET | F. 6

SPECIALJA PO SHQYRTON
MUNDËSINË QË TA MODIFIKOJË
EDHE DËNIMIN E NASIM
HARADINAJT | F. 3


EKONOMI



KONJUFCA PRITI NË TAKIM
DELEGACIONIN E ODËS TREGTARE
TË ANKARASË, FOLËN PËR
INVESTIME NË KOSOVË | F. 8

BORDI I AKP-së DISKUTOI
PËR VENDIME TË RËNDËSISHME
QË LIDHEN ME PROCESIN
E PRIVATIZIMIT | F. 8

SPORT



SHQIPËRIA KA GJASA 99 PËR QIND
TË SHKOJË NË 'EURO 2024',
KOSOVA 1 PËR QIND TË MUNDËSIVE
F. 10

MACRONI E LË SI
MUNDËSI TË
HAPUR PEZULLIMIN
E VIZAVE PËR
KOSOVËN | FAQE 3



MINISTRI I
MBROJTJES I
TUROISË:
BASHKËPUNIMI
MES TË DY
VENDEVE TONA PO
THELLOHET ÇDO
DITË E MË SHUMË
| FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Vrasjet në Francë e Belgjikë, frikë për sigurinë në Evropë. Gjermania, në alarm

BERLIN, 17 TETOR - Vrasja e dy suedezeve në Belgjikë tronditi Evropën, e pohuar kjo dhe nga vetë presidenti francez Emmanuel Macron gjatë vizitës në Shqipëri.

Një ditë përpara episodit të dhunshëm në Bruksel, një mësues u ekzekutua në Francë. Në të dy rastet akti ekstrem është shoqëruar me thirrjet "Allaku Ekber", duke dëshmuar qartë se frika e një rishfaqjeje të krimeve të urrejtjes mes konfliktit të rindezur izraelito-palestinez po bëhet realitet.

Brukseli po e trajton sulmin si akt terrorist. E ka ngritur gjendjen e gatishmërisë, edhe pse agresori, një ekstremist i dyshuar tunizian,

është qëlluar e vrarë sot nga policia.

Lufta në Lindjen e Mesme po ndikon edhe në situatën e sigurisë në Gjermani, e pohuar kjo nga kreu i Bordit të Kontrollit të Shërbimit Sekret, Konstantin von Notz. "Gjendja edhe kështu ishte mjaft e tensionuar, ndër të tjera, për shkak të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, por është përkeqësuar ndjeshëm tani pas ngjarjeve të fundit në Lindjen e Mesme", tha ai.

Ambasadori i Izraelit në Gjermani, Ron Prosor, paralajmëroi se "asnjë lloj Gaze nuk duhet të lejohet të shfaqet në tokën gjermane".

Një rrezik i tillë kërcënon, nëse shoqatat si rrjeti palestinez



Samidoun dhe mbështetësit e tjerë të Hamasit vazhdojnë të abuzojnë me demokracinë gjermane, tha ai në një program të

përbashkët mëngjesi të shërbimeve televizive publike gjermane ARD dhe ZDF. Anëtarët e shoqatës palestineze

Samidoun dhe simpatizantët e tyre festuan sulmet e Hamasit ndaj Izraelit në rrugët e Berlinit dhe qyteteve të tjera gjermane. "Gjermania nuk duhet të lejojë më që yjet e Davidit të shënohen në shtëpitë hebreje në Berlin, prandaj shumë hebrej nuk guxojnë më të dalin në rrugë", tha ai.

Lidhur me situatën aktuale në Izrael, Prosor shtoi se është e qartë "që popullsia palestineze në Rripin e Gazës duhet të çlirohet nga Hamasi".

Pavarësisht prej përpjekjeve të tij më të mira, Izraeli, sipas tij, nuk mund ta garantojë mbrojtjen e popullatës së pafajshme civile për sa kohë që Hamasi i përdor këta njerëz si mburoja.

Ukraina thotë se i shkatërroi 9 helikopterë rusë



DONJECK, 17 TETOR - Ushtria e Ukrainës tha të martën se i ka shkatërruar nëntë helikopterë gjatë bombardimit të fushave ajrore pranë qyteteve të uzurpuara nga Rusia, Luhansk dhe Berdiansk. Një qitës kundërajror, teknologji e veçantë dhe arsenal i tërë u shkatërruan, po ashtu, sipas Ushtrisë së Ukrainës.

Si pasojë e sulmeve u dëmtuan

edhe pistat e fushave ajrore. Pala ruse nuk i ka komentuar këto sulme.

Shpërthimet në depot e municioneve vazhduan për disa orë dhe dhjetëra ushtarë rusë raportohet të jenë vrarë dhe plagosur, sipas zyrtarëve ukrainas.

Fushat ajrore ndodhen rreth 90 kilometra larg vijës së frontit.

Blogerët e Ushtrisë së Rusisë i kanë përshkruar këto sulme si më të rëndat ndaj bazave ajrore të Rusisë qëkur nisi pushtimi i plotë i Ukrainës nga Moska gati 20 muaj më parë. Më herët gjatë ditës së martë, mediet lokale në Berdiansk raportuan se mbrojtja kundërajrore ishte përdorur, por pa komentuar për dëme apo viktima të mundshme.

Palestinezët raportojnë për granatime të ashpra në jug të Gazës

GAZA, 17 TETOR - Palestinezët në Gazë mëngjesin e së martës kanë raportuar për granatime të ashpra në qytetet jugore të Kan Younis dhe Rafah, ku Izraeli ka urdhëruar civilët që të evakohen.

Bombat izraelite kanë goditur juglindjen e Kan Younisit dhe perëndimin e Rafahut, sipas raporteve lokale.

Mijëra persona që po tentojnë të largohen nga Gaza janë mbledhur në Rafah. Aty gjendet pikëkalimi i vetëm kufitar që lidh këtë territor me Egjiptin.

Ndërmjetësit ndërkombëtarë po bëjnë presion që të arrihet një marrëveshje që ndihma humanitare të arrijë në Gazë dhe që refugjatët dhe shtetasit e huaj të lejohen të largohen për në Egjipt.

Si pasojë e sulmeve në Deir al Bala në jug të qytetit të Gazës janë vrarë nëntë anëtarë të një familjeje - shumica e viktimave ishin gra dhe fëmijë. Tre anëtarë



të një familjeje tjetër, që ishin evakuuar nga qyteti i Gazës, u vranë teksa po strehoheshin në shtëpinë e një fqinji. Dëshmitarët thanë se nuk ka pasur paralajmërim para sulmeve.

Në Kan Younis, pak metra larg

spitalit Nasser, është shkatërruar një shtëpi dhe të paktën katër anëtarë të një familjeje u vranë gjatë sulmit, thanë banorët lokalë. Raportohet se vetëm dy persona kanë mbijetuar në sulmin ndaj kësaj shtëpie.

Izraeli ka urdhëruar mbi një milion palestinezë që të evakohen nga veriu për në jug të Gazës, pasi dëshiron që të kryejë një sulm masiv ndaj militantëve palestinezë të Hamasit.

Ushtria izraelite ka thënë se po

tenton t'i largojë civilët për në zona të sigurta para se të nisë një fushatë të madhe kundër Hamasit në veri të Gazës, ku ka thënë se militantët kanë rrjet të zgjeruar të tuneleve dhe të raketahedhësve. Shumica e infrastrukturës ushtarake e Hamasit gjendet në zonat e banuara.

Kombet e Bashkuara kanë thënë se mbi 1 milion palestinezë janë larguar nga shtëpitë e tyre dhe tani gjenden në zonën e evakuimit në jug, të gjatë pothuajse 14 kilometra.

Militantët e Hamasit kryen sulme të koordinuara nga toka, ajri dhe deti më 7 tetor. Sipas të dhënave, të paktën 2 778 persona janë vrarë dhe 9 700 të tjerë janë plagosur në Gazë. Mbi 1 400 izraelitë janë vrarë, shumica e të cilëve civilë që u vranë gjatë sulmeve të Hamasit më 7 tetor.

Izraeli është zotuar se do t'i zhdukë militantët e Hamasit.

GJYKATA SPECIALE LIRON NGA BURGU HYSNI GUCATIN

Hysni Gucati kthehet në Kosovë, pritët nga familjarët dhe bashkëluftëtarët

Dhomat e Specializuara në Hagë njoftuan se kanë modifikuar dënimin ndaj ish-kreut të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati, duke i mundur atij lirin nga burgu me disa kushte. Sipas njoftimit të Speciales, kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, konstatoi se Gucati kishte reflektuar për veprimet e tij gjatë qëndrimit në objektin e paraburgimit në Hagë dhe "sjellja e tij kishte ndryshuar me kalimin e kohës"

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 TETOR - Hysni Gucati, ish-kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është pritur të martën në vendlindje, Morinë të Skenderajt, nga familjarë dhe bashkëluftëtarë.

Gucati nuk ka pranuar të deklarojë për medie, duke kërkuar të kursethet nga pyetjet e tyre. Por shumë shkurt ai u ka thënë të pranishmëve në odën e tij, se të fala kanë prej të gjithëve, madje u shpreh se ata që janë në Hagë janë më të fortë se kurrë. "Më kurseni mundësisht. Të fala ju kanë ba tanëve. Të jeni të bindur te Zoti që ata janë më të fortë se na", ka thënë Gucati.

Dhomat e Specializuara në Hagë njoftuan se kanë modifikuar dënimin ndaj ish-kreut të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Hysni Gucati, duke i mundur atij lirin nga burgu me disa kushte. "Më 12 tetor 2023 kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK), gjykatëse Ekaterina Trendafilova, vendosi ta modifikojë dënimin e z. Hysni Gucati për lirin e tij më 18 tetor 2023 ose rreth kësaj date, me kushtet e përcaktuara në vendim. Këto kushte do të jenë në fuqi gjatë pjesës së mbetur të dënimin të dhënë nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht për pjesën e mbetur të dënimin me katër vjet e tre muaj. Për marrjen e vendimit, kryetarja u këshillua me gjykatësit



e paneleve që dhanë dënimin sikurse parashihet në nenin 51(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), mori parasysh faktorët e rregullës 196(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave si dhe mbajti seancë me z. Gucati", thuhet në njoftim.

Në arsyetimin e lirit thuhet se ishin disa faktorë që kanë peshuar në favor të modifikimit të dënimin të tij. Në njoftimin e lëshuar për medie thuhet se ish-kreu i OVL UÇK-së ka shprehur pendesë për

veprimet e bëra, për të cilat edhe mori dënim. "Kryetarja mori parasysh se megjithëse veprat penale për të cilat z. Gucati u dënua janë padyshim të rënda, duke marrë parasysh efektin mjaft negativ të zbulimit të informacionit konfidencial mbi dëshmitarë (të mundshëm), ishin disa faktorë që peshuan në favor të modifikimit të dënimin të tij. Vlen të theksohet se kryetarja konstatoi se z. Gucati pati mundësi të reflektonte për veprimet e veta gjatë mbajtjes së tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe se

sjellja e tij kishte ndryshuar me kalimin e kohës. Kryetarja theksoi shprehjet e pendesës së z. Gucati, në veçanti, veçanërisht faljen, gjatë seancës gojore, që ai shprehimisht u kërkoi të gjithë atyre që mund të ishin ndierë të kërcënuar nga veprimet e tij. Gjithashtu, kryetarja vuri në dukje zotimin e vendosur të z. Gucati se nuk do të përfshihej në veprime të tjera që mund të karakterizoheshin si vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe se do t'i përmbushë të gjithë kushtet e përcaktuara për lirin e tij. Kryetarja theksoi se në qoftë se z. Gucati nuk përmbush cilindo prej kushteve të përcaktuara në vendim, atëherë vendimi do të anulohet", thuhet në njoftimin e Speciales.

Në maj të vitit 2022 Gucati së bashku me zëvendësin e tij në OVL UÇK, Nasim Haradinaj, u dënua me katër vjet e gjysmë burim për akuzat për pengim të drejtësisë. Më pas Apeli ua uli dënimet për tre muaj. Që të dy u arrestuan më 5 shtator të vitit 2020 dhe që atëherë gjendeshin në mbajtje në Hagë.



Specialja po shqyrton mundësinë që ta modifikojë edhe dënimin e Nasim Haradinajt

PRISHTINË, 17 TETOR - Më 12 tetor 2023 kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK), gjykatëse Ekaterina Trendafilova, vendosi se ajo do ta shqyrtojë modifikimin e vendimit të Nasim Haradinajt për lirin e tij me disa kushte pasi të marrë raport prej administratores Fidelma Donlon në lidhje me sjelljen e Haradinajt gjatë mbajtjes së tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së. "Për marrjen e vendimit, kryetarja u këshillua me gjykatësit e paneleve që dhanë dënimin sikurse parashihet në nenin 51(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), mori parasysh faktorët e

rregullës 196(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave si dhe mbajti seancë me z. Haradinaj. Kryetarja mori parasysh se megjithëse veprat penale për të cilat z. Haradinaj u dënua janë padyshim të rënda duke marrë parasysh efektin mjaft negativ të zbulimit të informacionit konfidencial mbi dëshmitarë (të mundshëm), ishin disa faktorë që mund të peshojnë në favor të modifikimit të dënimin të tij. Kryetarja, gjithashtu, vuri në dukje shprehjet e keqardhjes prej z. Haradinaj gjatë seancës gojore dhe zotimit të tij për moskryerjen e veprimeve të tjera që mund të karakterizohen si vepra penale

kundër administrimit të drejtësisë. Sidoqoftë, kryetarja theksoi se z. Haradinaj ka precedentë disiplinorë në Njësinë e Paraburgimit (NJP). Rrjedhimisht, kryetarja gjykoj se megjithëse z. Haradinaj ka ndërmarrë disa hapa drejt rehabilitimit, ka ende vend për përmirësim. Për këtë arsye kryetarja urdhëroi administratoren që të paraqesë raport në lidhje me sjelljen e Haradinajt në NJP në të ardhmen brenda një periudhe të caktuar në kontekst të vendimit mbi modifikimin e dënimin të tij", është thënë në njoftimin e Speciales.





Macroni e lë si mundësi të hapur pezullimin e vizave për Kosovën

Gjatë vizitës në Tiranë, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, e ka lënë si mundësi të hapur pezullimin e vizave për Kosovën. Ai ka pohuar se Franca bëri një “gest besimi sa i përket çështjes së vizave për Kosovën” por, sipas tij, fjala nuk po mbahet, duke iu referuar zhvillimeve në Kosovë. “Sa i përket Francës, ato [vizat] janë hequr sepse ne respektojmë fjalën e dhënë. E sot, fjala nuk po mbahet. Pres një angazhim real nga këto dy autoritete [Kosova dhe Serbia] që të ecin përpara në javët e ardhshme. Ky është vetë kushti për paqe në gjithë rajonin”, ka deklaruar Macroni

“Epoka e re”

TIRANË, 17 TETOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë në Tiranë më 17 tetor se Franca bëri një “gest besimi sa i përket çështjes së vizave për Kosovën”. “Dua ta them një gjë me shumë qartësi. Ne kemi bërë një gest besimi për çështjen e vizave. Sa i përket Francës, ato [vizat] janë hequr sepse ne respektojmë fjalën e dhënë. E sot, fjala nuk po mbahet. Pres një angazhim real nga këto dy autoritete [Kosova dhe Serbia] që të ecin përpara në javët e ardhshme. Ky është vetë kushti për paqe në gjithë rajonin”, ka deklaruar

Macron.

Nga disa media në Kosovë dhe Shqipëri është raportuar se Macroni ka deklaruar në Tiranë se Franca ka suspenduar vendimin për liberalizimin e vizave.

Agjencia franceze e lajmeve, AFP, lidhur me deklaratën e Macronit në Tiranë për vizat, tha se me këtë “ai e ka kërcënuar Kosovën me zhbërjen e vendimit të vizave”.

Nga Zyra e Presidentit të Francës kanë dhënë sqarime lidhur me këtë çështje përmes një deklaratë për mediet shqiptare.

Zyra e Presidentit të Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën ‘mbetet e hapur’.

“Presidenti ka folur për tensionet në mes të Serbisë dhe Kosovës. Ai tha se cilat ishin kërkesat tona. Në këtë kontekst dhe duke marrë parasysh bllokadën e Prishtinës, presidenti vlerësoi se çështja e liberalizimit të vizave mbetet e hapur”, tha Zyra e Presidentit të Francës në një përgjigje për median “ABC News”. Vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën pritet të hyjë në fuqi më 1 janar 2024.

Macroni foli për vizat në Tiranë duke e ndërlidhur situatën politike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjatë konferencës për media në Shqipëri, ai tha se ka ndjekur rritjen e tensioneve mes Kosovës dhe Serbisë dhe kërkoi që të dyja palët të

ndërmarrin hapa për ta shtensionuar situatën. “Është përgjegjësi e [presidentit të Serbisë, Aleksandar] Vuçiqit t’i dënojë prerazi sulmet e 24 shtatorit, sepse kontribuon në kthimin e qetësisë në kufi. Dhe, në etapat e ardhshme ajo që presim nga autoritetet, nga të dyja palët, është e thjeshtë: Riorganizimi i zgjedhjeve në komunat e banuara me shumicë serbe, pjesëmarrja e serbëve në zgjedhje e institucione, krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe nga autoritetet kosovare. Pres që Vuçiqi të jetë i përgjegjshëm dhe të njëjtën gjë pres edhe nga presidentja dhe kryeministri i Kosovës”, ka thënë Macroni. Ndërkaq kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se shqiptarët në rajon janë në ditët e tyre më të mira, porse Kosova e ka futur veten në një, siç është shprehur ai, kurth. “Folëm dje, në samit, me Kurtin dhe Bërnabiqin për situatën. Po sjell një fjalë të Mark Rutte kur iu drejtua të dyve. ‘Mos harroni kurrë se një kompromis më shumë se çfarë do të fitosh është çfarë nuk duhet të humbasësh’. Nëse bëjmë një llogari të gjërave për t’u humbur nga

shqiptarët, është shumë më e madhe e me kosto më të lartë se llogaria e atyre që duam të fitojmë duke i marrë këto që kemi si të mirëqena që nuk i humbim’. Shqiptarët në rajon janë në ditët e tyre më të mira. Kosova është futur vetë në një kurth që ia ka bërë vetes. Do të ishte dramatike të humbiste të drejtën për të hyrë në BE. Të dyja palët kanë një plan, ai franko-gjerman, që është [gjëja] më e mira që mund t’i ndodhë Kosovës”, ka thënë Rama.

Ai ka rikujtuar shembullin që i kishte thënë ish-presidenti amerikan Bill Clinton kur ishte për vizitë në Shqipëri. “Thuaju miqve të mi në Prishtinë se si i ndodhi Palestinës (ende pa nisur sulmet). Arafat kishte në tryezë marrëveshjen më të mirë të mundshme, Izraeli tha se do ta firmosë, të nesërmen ndërroi mendje. Palestina është shkatërruar jo nga Izraeli, por nga klasa e vet politike. E mira e madhe e Kosovës është ta firmosë dhe ekzekutoi të gjithë marrëveshjen edhe sikur Serbia të mos e dojë kurrë, pastaj t’ia lërë në dorë BE-së”, ka rikujtuar Rama.

Osmani kërkon nga KE-ja të vendosë masa ndëshkuese ndaj Serbisë

PRISHTINË, 17 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se hetimet e deritanishme të kryera nga autoritetet vendore, të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë, "kanë dëshmuar se Serbia qëndron" pas sulmit të 24 shtatorit në Banjškë të Zveçanit. Ajo kërkoi që Komisioni Evropian të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj Serbisë.

Në një konferencë për medie, Osmani tha se shteti i saj po kërkon që blloku evropian të vendosë masa ndaj Serbisë për shkak të Banjškës, pasi shtetet anëtare t'i kenë kryer procedurat e tyre për konfirmimin e detajeve të kësaj ngjarjeje. Ajo tha se Kosova nuk po kërkon sanksione, sepse çdo shtet anëtar ka të drejtë vetoje në Këshillin e BE-së dhe të paktën një shtet - pa specifikuar se për cilin shtet bëhet fjalë - do ta përdorte veton për këtë çështje. Komisioni Evropian, tha Osmani, ka të drejtë dhe kompetenca që të paraqesë masa politike dhe financiare, që nuk kërkon miratim të Këshillit. Në BE kanë thënë se po presin

përfundimin e hetimeve të autoriteteve kosovare për ngjarjet në Banjškë dhe më pas do të mund të ndërmerren masa dhe hapa të rinj.

Parlamenti Evropian pritet të miratojë një rezolutë më 19 tetor, e cila, sipas burimeve të Radios Evropa e Lirë në bllokun evropian, do ta kërkojë vendosjen e masave ndëshkuese ndaj Serbisë.

Një grup i armatosur serbësh sulmuan policinë e Kosovës më 24 shtator, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Serbia ka mohuar se ka gisht në këtë sulm.

Gjatë konferencës, Osmani tha se janë katër elemente që, sipas saj, e çojnë përgjegjësinë për sulmin përmes linjës komanduese "deri te presidenti serb [Aleksandar Vuçiq]". E para, sipas saj, ka të bëjë me financimin e këtij grupi - që Kosova ka thënë se përbëhet prej më shumë se 80 personash të armatosur, e dyta me armët e përdorura që, sipas Osmanit, janë "prodhuar në industrinë ushtarake të Serbisë dhe janë dhënë nga shteti serb për



terroristët që e kanë kryer sulmin". "E treta ka të bëjë me trajnimet të cilat as shteti serb nuk i mohon se i ka bërë për këto grupe terroriste. E katërta ka të bëjë me lidhjet politike të vet shtetit serb me terroristët që e kanë udhëhequr këtë sulm", tha Osmani.

Osmani fajësoi qasjen e BE-së ndaj Serbisë që, sipas saj, e ka

"inkurajuar" Vuçiqin për një sulm të tillë. "Tashmë janë bërë 12 vjet në dialog dhe është koha për reflektim sepse qasja e këtyre 12 vjetëve e ka inkurajuar Vuçiqin që ai të përdorë dhunë dhe të kryejë akt agresioni ndaj Kosovës. Andaj nuk mund të sillemi kinse nuk ka ndodhur 24 shtatori. I gjithë procesi i dialogut duhet të rimendohet në suaza të asaj që ka ndodhur më 24 shtator,

duke e ditur se është shkelje e nenit 3 të Marrëveshjes drejt normalizimit dhe Aneksit të saj", tha Osmani.

Përgjegjësinë për organizimin dhe udhëheqjen e sulmit e ka marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq. Kosova ka publikuar pamje të incizuara me dron ku Radoičiqi shihet i armatosur në Banjškë më 24 shtator.

Macroni: E ardhmja e Shqipërisë është plotësisht në Evropë

Prej vitit 1912 asnjë president i Republikës së Francës nuk e kishte vizituar Shqipërinë, por më 17 tetor 2023 Emmanuel Macron u bë presidenti i parë francez që vizitoi Shqipërinë. Ai në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Edi Rama, ka theksuar se e ardhmja e Shqipërisë është plotësisht në Evropë

TIRANË, 17 TETOR - Presidentin francez Emmanuel Macron, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, ka thënë se ardhmja e këtij vendi është plotësisht në Evropë. Macroni në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Edi Rama, ka theksuar se kjo vizitë në Shqipëri është një formë riangazhimi i Francës për këtë vend dhe rajonin në përgjithësi. Ai ka thënë se ishte një gabim i thellë që prej vitit 1912 asnjë president i Republikës Franceze nuk kishte ardhur në Shqipëri. "Dua të shoh nga e ardhmja. Delegacioni që më shoqëron tregon për vullnetin tonë. Isha shumë i lumtur që i dorëzoza dekoratën Kadaresë. Isha i lumtur për darkën, që shoqërohej nga performanca e Prelocajt. Ecim bashkërisht për liceun francez të Korçës. Shpresojmë të jemi në anën tuaj në ambicien tuaj për turizmin. Franca do të angazhohet që t'i formojë shqiptarët e rinj në zanate. Kemi vullnetin për ta hapur shkollën 42 për zanatet digjitale. Do ta zhvillojmë Shqipërinë në reformën ekonomike. 210 milionë euro janë hedhur që prej vitit 2019 dhe më shumë do të hidhen deri më 2027 sipas prioriteteve tuaja. Gëzohem për ato që kemi arritur

në bashkëpunimin e kriminalitetit. Do të vazhdojmë të ecim përpara me këtë dinamikë. Jam i bindur që vendi juaj është i ankoruar në Evropë. Të jem me ju sot, është të shpreh një moment të rëndësishëm të kohës historike që po jeton Evropa. Po hyjmë në një erë të re. Në erën e ribashkimit! Edhe ju e thatë se jeni një popull që e doni Evropën. Mendoj se kjo është kryesorja. Ky bashkim është për popujt sovranë që e kërkojnë. E ardhmja juaj është plotësisht në Evropë. Synojmë një bashkim mes



të ngjashmish, ku të flasim për çështje të përbashkëta", ka thënë Macron.

Ndërkaq kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se është i lumtur që sot është krah presidentit të Republikës së

Francës jo në Paris, jo në Bruksel, por në Tiranë. "Me protokollin diplomatik fjala 'i lumtur' përdoret shpesh. Sa herë gjendem në situatë si kjo ku duhet shprehur kënaqësia për praninë e një mikut të çmuar, evitoj fjalën lumtur që sugjeron ministria e Jashtme në fjalimet e mia dhe them i kënaqur. Sot dëshiroj të them me plot gojë që jam i lumtur që jam në krah të presidentit të Republikës së Francës, jo në Paris, jo në Bruksel, por në Tiranë", është shprehur Rama, duke shtuar se është shumë i lumtur që pas një pritjeje, të paktën shekullore, në Shqipëri vjen për një vizitë bilaterale shefi i shtetit të Francës. "Kjo vizitë është shumë më tepër se një vizitë formale. Është një vizitë miqësore dhe angazhimi për ta thelluar më tej për një marrëdhënie midis Francës dhe Shqipërisë. Po t'i shohim të dhënat konkrete, ka njohur një zhvillim të lartë si

rezultat i një riangazhimi të Francës në rajon, përmes angazhimit të presidentit në kërkim të një marrëdhënie konkrete dhe produktive për BE dhe BP, një marrëdhënie që duhet ta kalojë procesin e integritimit evropian dhe duhet të jetë në gjendje që në çdo hap t'i japë në gjendje rajonit që të jetë në BE", ka thënë Rama.

Gjithashtu, Rama ka thënë se është i lumtur që presidenti Macron e tha shumë qartë se zgjerimi i BE-së nuk duhet ta pengojë ribashkimin e Evropës dhe, për këtë, thotë Rama, është me shpresë plotë se presidenti Macron do të kërkojë një angazhim të procesit evropian për të ndërtuar një binar të një treni ku çdo vend do ta bëjë detyrën e vet. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, në kuadër të kësaj vizite, i ka dorëzuar shkrimtarit Ismail Kadare dekoratën e "Oficerit të Madh të Legjionit të Nderit".

Begaj pret Macronin: Marrëdhëniet Shqipëri - Francë kanë hyrë në një fazë të re shumë dinamike

Me presidentin francez është takuar edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj. Ky i fundit ka thënë se ishte nder dhe privilegj ta priste në takim presidentin Macron, në vizitën e parë zyrtare të një presidenti francez në Shqipëri. "Mirënjohje për mbështetjen e vyer që Franca dhe presidenti Macron po i japin integritimit


evropian të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Procesit të Berlinit, dhe mbështetjes së procesit të zgjerimit. Marrëdhëniet e konsoliduara e të partneritetit strategjik midis dy vendeve kanë hyrë në një fazë të re shumë dinamike", ka shkruar Begaj në "Facebook".

Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë fillon vizitat në institucionet shkollore

MALISHEVË, 17 TETOR - Bazuar në obligimet që dalin nga plani i punës i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim (DAE) në komunën e Malishevës për vitin 2023 dhe në ushtrim të përgjegjësisë për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor, kanë filluar të realizohen vizita me karakter pune, takime me institucionet arsimore, personelin arsimor, prindërit, nxënësit dhe të gjithë komunitetin shkollor. Komuna e Malishevës ka njoftuar se këto vizita dhe

takime do të bëhen me qëllim të identifikimit të nivelit të zbatimit të përgjegjësisë që janë të vendosura në obligimet kontraktuese dhe angazhimet për cilësi në procesin edukativo-arsimor nga DAE te personeli arsimor, menaxhmenti i shkollave, prindërit dhe nxënësit dhe gjithashtu këto angazhime do të jenë të fokusuar për të arritur një performancë më të mirë të institucioneve arsimore. “Në këto angazhime do të marrë pjesë drejtoresha e DAE-

së, Arbëresha Krasniqi, e shoqëruar nga stafi, gjithashtu të angazhuar drejtpërdrejt janë edhe zyrtarët e autorizuar të drejtorisë. Vizitat me karakter të vlerësimit të punës sonë të përbashkët do të fillojnë të realizohen nga sot dhe do të ketë vlerësime të punëve, të cilat do të listohen në kuadër të performancës së shkollës dhe bazuar në këto vlerësime do të shpallet stafi më i mirë menaxhues i muajit. Këto vizita do të jenë të përditshme”, ka njoftuar komuna e Malishevës.



BE-ja konfirmon vizitën e pesëshes në Kosovë dhe Serbi, kërkon përparim konkret



PRISHTINË, 17 TETOR - Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Peter Stano, ka konfirmuar të martën se përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun, Mirolslav Lajčak, i shoqëruar nga këshilltarët e lartë të liderëve të Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të udhëtojnë të shtunën, më 21 tetor, në Kosovë dhe Serbi, për t'u takuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Krahas Lajçakut, në këtë vizitë do

të jenë edhe Emanuel Bonne, këshilltar për siguri dhe politikë të jashtme i presidentit të Francës, ai i kancelarit gjerman Jens Plotner, dhe i kryeministres së Italisë, Francesco Talo. Me ta do të jetë në delegacion edhe i dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. “Qëllimi i kësaj vizite është për të arritur përparim konkret në zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit dhe shtensionimin pas zhvillimeve të fundit. BE-ja dhe vendet anëtare, sikurse edhe Shtetet e Bashkuara

të Amerikës, mbesin mbështetëse të mëdha të procesit të normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe së ardhmes evropiane të të gjithë rajonit. Kemi pritje të qarta nga palët që ta vazhdojnë procesin e normalizimit dhe të kryejnë pa vonesa dhe pa kushte obligimet e tyre”, ka thënë zëdhënësi Peter Stano. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ishin takuar për herë të fundit në një takim të nivelit të lartë në kuadër të

dialogut më 14 shtator. Në atë takim ata kishin dështuar që të pajtoheshin për një plan për sekuencimin e zbatimit të marrëveshjeve. Për këtë, BE-ja ia kishte lënë përgjegjësinë palës kosovare, ndonëse kishte thënë se të dyja palët kanë dështuar për përmbushjen e obligimeve nga marrëveshja e arritur në dialog. Ndërkohë, BE-ja i ka mbajtur në fuqi masat ndëshkuese ndaj Kosovës dhe është duke shqyrtuar vendosjen e masave ndaj Serbisë, nëse dëshmohet lidhja e saj me sulmet e fundit në

Banjskë në veri të Kosovës më 24 shtator, ku u vra një pjesëtar i Policisë së Kosovës. Në përleshjet që pasuan mes grupit të armatosur dhe Policisë së Kosovës, u vranë tre sulmues. Kosova e akuzoi Serbinë se tentoi ta “aneksojë tërë veriu e Kosovës” gjatë sulmit në Banjskë, përgjegjësinë për të cilin e mori Millan Radoičiq, nënkryetar i deriatëhershëm i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, ndërsa Serbia i mohoi akuzat.

Policia: Qytetarët në veri kërkojnë vazhdimin e afatit për targat

PRISHTINË, 17 TETOR - Drejtoria e Policisë së Kosovës për rajonin e veriut ia ka përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës kërkesën e qytetarëve për shtyrjen e afatit për reregjistrimin e automjeteve me targa serbe në ato kosovare. Kështu ka thënë për “Radion Evropa e Lirë”, zëvendës drejtori i policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani, duke theksuar se me këtë kërkesë u janë drejtuar qindra qytetarë. “Pres që

shpejt të marrim përgjigje nga MPB-ja. Presim një përgjigje pozitive”, ka thënë Elshani. Bëhet fjalë për reregjistrimin e automjeteve me targa të lëshuara nga autoritetet serbe me akronimet e qyteteve të Kosovës, si KM (Kosovska Mitrovica), GL (Gjilan), PR (Prishtina) e kështu me radhë. Çështja e targave ishte ajo që shkaktoi një sërë krizash në veri të Kosovës. Fillimisht, më 31 korrik të vitit të kaluar u ngritën barrikada

për shkak të kësaj çështjeje. Më pas, në nëntor, serbët u larguan nga institucionet e Kosovës në veri për shkak se ishte suspenduar drejtori i policisë për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq, i cili refuzoi ta zbatonte vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e automjeteve me targa RKS. Plani i Qeverisë së Kosovës i tetorit të vitit të kaluar parashihte që nga 21 prilli 2023 të lejohet qarkullimi i automjeteve vetëm me targa RKS.



Osmani nuk dekreton Blerim Isufajn në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 17 tetor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar të martën se nuk e ka dekretuar Blerim Isufajn në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës më 8 prill 2022 i kishte dërguar propozimin Presidencës me emrin e Isufajt. Në një konferencë për media në Prishtinë, Osmani renditi disa shkelje ligjore që tha se janë gjetur në procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit, prandaj ajo ka marrë vendim që të mos e dekretojë atë.

Presidentja tha se i ka kërkuar Këshillit Prokurorial të propozojë një emër tjetër për këtë pozitë, duke u bazuar në merita dhe transparencë.

Osmani tha se për vlerësimin që ka bërë Presidencën për çështjen e kryeprokurorit janë marrë parasysh vlerësimet e bëra nga organizatat

joqeveritare dhe institucionet ndërkombëtare.

Ajo tha se për çështjen e kryeprokurorit është përballur me presione të paligjshme. "Ka pasur njerëz që dërgonin mesazhe se 'në qoftë se nuk e dekreton, do të vëmë dosje, do të ngremë aktakuza'", tha Osmani, duke e cilësuar si "shqetësuese" idenë që personat brenda sistemit mund ta kërcënojnë presidenten e vendit për një çështje.

Ehat Mihtaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka shkruar në "Facebook" se vendimi i Osmanit është në linjë me qëndrimet e shprehura nga organizatat joqeveritare, ambasadat, Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë dhe Komisioni Evropian. "Këshilli Prokurorial ka dështuar të udhëheqë një proces të bazuar në meritokraci dhe integritet", ka shkruar Mihtaraj.

Të zhgënjyer me procesin e përzgjedhjes vitin e kaluar janë



shprehur edhe Bashkimi Evropian, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara. Me ligjin në Kosovë kryeprokurori duhet të dekretohet nga presidenti i shtetit.

Në garë për pozitën e

Kryeprokurorit të Shtetit, përveç Blerim Isufajt, kanë qenë edhe Armend Hamiti, Lulzim Sylejmani, Shqipdon Fazliu dhe Kujtim Munishi.

Kryeprokurorit të deritashëm të

Shtetit, Aleksandër Lumezi, i ka skaduar mandati më 21 prill 2022. Aktualisht ushtrues i detyrës është Besim Kelmendi, i cili i ka kompetencat e plota të Kryeprokurorit të Shtetit.

Ministri i Mbrojtjes i Turqisë: Bashkëpunimi mes të dy vendeve tona po thellohet çdo ditë e më shumë



PRISHTINË, 17 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të martën me nderime të larta ushtarake ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, Yasar Guler dhe delegacionin e tij. Ministri turk i mbrojtjes në vizitën e tij zyrtare u prit në takime të ndara, fillimisht me ministrin Maqedonci, më pas me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Gjithashtu, pas takimeve të mbyllura, u mbajt takimi në mes të delegacioneve të larta të të dyja vendeve. Në konferencën për medie ministri Maqedonci i shprehu mirëseardhje homologut të tij dhe e falënderoi Republikën e Turqisë për gjithë ndihmën që i ka ofruar shtetit të Kosovës përgjatë çdo etape të zhvillimit.

Më tej, ministri Maqedonci

theksoi se: "Republika e Turqisë ka qenë dhe vazhdon të mbetet partnere strategjike për Republikën e Kosovës dhe se bashkëpunimi mes vendeve tona është ndërtuar mbi shtylla të forta të parimeve dhe besimit reciprok prandaj, si i tillë, ai do të vazhdojë të thellohet dhe patjetër do të jetë i qëndrueshëm në kohë".

Gjithashtu, ministri Maqedonci shprehu mirënjohjen për mbështetjen që kemi marrë nga shteti mik përgjatë secilës fazë të zhvillimit të ushtrisë sonë, qoftë përmes realizimit të trajnimeve të përbashkëta ndërmjet dy ushtrive, edukimit të ushtarakëve të rinj, po ashtu ngritjes së kapaciteteve luftarake, përmes realizimit me sukses të blerjeve shtet me shtet, të cilat kanë përmbyshur nevojat e furnizimit të përcaktuara sipas objektivave të planit të zhvillimit.

Në këtë aspekt, me theks të veçantë, ministri Maqedonci ka kërkuar nga ministri Guler mbështetje për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Programin e Partneritetit për Paqe dhe ka theksuar rëndësinë e anëtarësimit tonë në NATO, si rrugë që garanton stabilitetin e Ballkanit Perëndimor.

Nga ana e tij, ministri Yasar Guler theksoi se bashkëpunimi në mes të dy vendeve tona po thellohet çdo ditë e më shumë dhe se Republika e Turqisë po bën përpjekje të mëdha për integrimin e Kosovës në organizatat euroatlantike. "Ne e përkrahim sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, unifikimin me institucionet euroatlantike dhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare", ka theksuar ministri Guler.

Haradinaj kritikon qeverinë Kurti: Nuk po e kupton dëmin që po ia shkakton Kosovës me qasjen mburravece

PRISHTINË, 17 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se eksponentët të qeverisë Kurti aksionin e 24 shtatorit e kanë kalkuluar në votë.

Haradinaj ka thënë se Kosova është shndërruar në problem të sigurisë, ndërsa qeveria Kurti mburret se si është rritur në përqindje. "Mburrja e eksponentëve të qeverisë Kurti dhe dëliri i tyre se pas 24 shtatorit janë rritur në

përqindje, tregon se sa keq është Kosova e sa kalkulantë janë ata. Këta njerëz harrojnë që në një operacion të rendit dhe të ligjit është vlarë një hero dhe Kosova është shndërruar në problem të sigurisë e paftyresisht mburren se si janë rritur në përqindje", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se këta njerëz harrojnë që para shumë vitesh Kosova është ndier e sigurt, dhe nisur nga ky fakt,

Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar patën tërhequr trupat e tyre në kuadër të KFOR-it dhe tash janë detyruar të rikthehen. "Këta njerëz nuk po e kuptojnë dëmin që po ia shkaktojnë Kosovës me qasjen e tyre mburravece dhe me të panjohurat që pasojnë kur çështja e sigurisë së brendshme kthehet në çështje të sigurisë ndërkombëtare", ka thënë Haradinaj.



Konjufca priti në takim delegacionin e Odës Tregtare të Ankarasë, folën për investime në Kosovë

PRISHTINË, 17 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, shoqëruar nga deputetë, anëtarë të Grupit të Miqësisë me Turqinë, ka pritur të martën në takim një delegacion nga Oda Tregtare e Ankarasë (ATO), kryesuar nga presidenti Gursel Baran. Në takim, ndër të tjera, u bisedua për fuqizimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare mes dy vendeve tona. “Kryetari Konjufca, pasi i njoftoi mysafirët në lidhje me infrastrukturën ligjore dhe mundësitë për investime në

Republikën e Kosovës, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit tregtar në fusha me interes për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe shprehu gatishmërinë për ta thelluar bashkëpunimin ekonomik me Odën Tregtare të Ankarasë dhe shtetin mik të Turqisë. Ai, po ashtu, inkurajoi investimet e kompanive turke në sektorët e ndryshëm të ekonomisë së Kosovës”, thuhet në njoftim, duke shtuar se delegacioni turk falënderoi kryetarin e Kuvendit për pritjen e ngrohtë dhe çmoi angazhimin e tij për nxitjen e

marrëdhënieve të ndërsjella tregtare. “Kryetari i Kuvendit dhe kryetari i ATO-s, i cili shoqërohej nga nënkryetari Halil Ibrahim Yilmaz, kryetari i Federatës Shqiptare, Hivzi Krusha, kryetari i Fondacionit Shqiptar për Kërkime Kulturore dhe Edukim i vendeve të Ballkanit dhe deputetë të Ankarasë, shprehën interesimin e dyanshëm për shtimin e bashkëpunimit të ndërsjellë të bizneseve me qëllim të avancimit të mëtejshëm të interesave të përbashkëta ekonomike



ndërmjet Republikës së Turqisë”, theksohet në Kosovës dhe Republikës së njoftimin e Kuvendit.


Bordi i AKP-së diskutoi për vendime të rëndësishme që lidhen me proceset e privatizimit

PRISHTINË, 17 TETOR - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) mbajti një mbledhje të jashtëzakonshme në të cilën u diskutua dhe u miratuan vendime të rëndësishme që lidhen me proceset e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin ligjor.

Kjo mbledhje u zhvillua në kuadër të përmirësimeve të fundit të drejtpërdrejta të Agjencisë. Gjatë kësaj mbledhjeje Bordi analizoi raportin e tremujorit të fundit, i cili është dërguar rregullisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për të siguruar një menaxhim sa më efikas të pasurisë publike, Bordi diskutoi dhe miratoi raportin e hulumtimit dhe rivlerësimit të çmimeve të qirave të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore.

Ky raport është bazuar në vendimin e mëparshëm të Bordit për rivlerësimin e çmimeve të të gjitha qirave të aseteve në pronësi shoqërore, me qëllim të përshtatjes me çmimet aktuale të tregut.

Ky proces i rivlerësimit ka përfshirë një numër të madh të kontratave aktive të qirave të aseteve në likuidim dhe aseteve nën administrim të drejtpërdrejtë të AKP-së, duke përfshirë edhe hartimin e kontratave të reja me qiramarrësit aktualë. Rezultat i



këtij procesi është rritja e të hyrave të përgjithshme për rreth 30 %. Një tjetër përmirësim që u diskutua dhe u miratua në këtë

mbledhje është lidhur me kërkesën e komunës së Gjilanit për rivlerësimin e qirasë për çerdhen për fëmijë.

Bordi i ka lejuar komunës së Gjilanit ta vazhdojë me çmimin e deritashëm të qirasë për këtë aset, duke marrë parasysh interesin

publik që ofrohet përmes shfrytëzimit të kësaj çerdheje. Bordi ka diskutuar edhe kërkesën e Agjencisë Qendrore të Prokurimit për marrjen me qira të shfrytëzimit të pronës së Ndërmarrjes “Mekanizimi” në Prishtinë.

Si rezultat i hyrjes në fuqi të strukturës organizative të re nga data 1 tetor 2023, Bordi ka miratuar disa amendamente të akteve nënligjore të AKP-së, duke përfshirë amendamentimin e Statutit të Bordit, Rregullores së Sekretarisë së Bordit, Procedurave Bankare të Fondeve në Mirëbesim, Rregullores për Investime në Letra me Vlerë, dhe Rregullores së Pagave të AKP-së.

Në vijim të përmirësimeve të këtij procesi, Bordi është përfshirë në shqyrtimin dhe aprovimin e shitjeve të aseteve me negociim direkt. Në këtë kontekst janë shqyrtuar 13 kërkesa për negociim direkt, kurse janë aprovuar vetëm dy nga to.

Bordi, gjithashtu, diskutoi për trajtimin e materialeve arkivore të Agjencisë dhe ndërmarrjeve shoqërore nën administrim ligjor të AKP-së. Kjo është një pasqyrë e përmirësimeve dhe vendimeve të fundit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së si pjesë e përpjekjeve për ta ndryshuar dhe përmirësuar menaxhimin e pasurisë publike në Kosovë.

Në Gjilan mbahet punëtorja 'Zhvillimi i planit të biznesit dhe regjistrimi i biznesit'

GJILAN, 17 TETOR - Në Gjilan është mbajtur punëtorja 'Property4Empowerment, Zhvillimi i Planit të Biznesit dhe Regjistrimi i Biznesit', organizuar nga komuna e Gjilanit në bashkëpunim me aktivitetin e USAID-it Qeverisja e Pronës.

Në këtë ngjarje ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, Alban Hyseni, së bashku me nënkryetaren Leonora Morina-Bunjaku. “Kjo punëtorja ka për

qëllim që në bashkëpunimin me sektorin privat të avokojë për fuqizim të grave dhe pjesëmarrje të tyre në aktivitete ekonomike. Punëtorja do të ofrojë këshilla dhe ndihmë teknike në hapat e para të biznesit duke ofruar informata lidhur me fillimin dhe rritjen e biznesit dhe ndihmuar në hartimin e planeve të biznesit. Gjatë trajnimit, gjithashtu, do të diskutohet për rëndësinë e posedimit dhe regjistrimit të

pronës në zhvillim të biznesit dhe mirëqenies sociale”, ka thënë Hyseni.

Në këtë punëtorja u tha, po ashtu, se kur gratë nuk kontrollojnë pronën, ato nuk mund të jenë aktore të plota ekonomike, prandaj adresimi i çështjes së zotimit të pronave nga gratë, promovon rritjen ekonomike dhe mbështet proceset e integritimit në Bashkimin Evropian.



Roli dhe të drejtat e gruas shqiptare në kohën e Perandorisë Osmane



Për një kohë të gjatë gruaja osmane është parë si një qenie e cila ishte e zhytur në injorancë, që e kalonte kohën në shtëpi e që merrej nëpër këmbë. Por, studimet e bëra dekadat e fundit nxorën në dritë detaje...

Nga: Eduart CAKA

Jeta e femrës në Perandorinë Osmane, veçanërisht në të drejtat që asaj i njihje ligji, ishte më e rregullt. Të gjitha këto kishin të drejtat që u garantoheshin nga shteti dhe në bazë të të cilave gëzonin privilegjet që u njihje ligji islam, siç ishin e drejta e trashëgimisë, e martesës, e divorcit etj. Përveç të drejtave në familje, si fejesa e martesja, por edhe trashëgimia, gruaja kishte të drejtë të menaxhonte të ardhurat e saj, të blinte ose shiste pronat, të shkante në gjykatë për çështje të ndryshme dhe të merrte pjesë në angazhime shoqërore – si ndërtimi i vakëfeve ose drejtimi i tyre. Duke qenë se edhe gjeografia shqiptare ishte pjesë e Perandorisë Osmane, të njëjtat fenomene dhe angazhime të gruas në pjesë të ndryshme të perandorisë vërehet se kanë qenë të dukshme edhe në trojet shqiptare.

Mungesa e mjaftueshme e literaturës së nevojshme për të nxjerrë një panoramë të jetës së gruas në këtë kohë, përbën një

pengesë në kuptimin e gjendjes së femrës shqiptare gjatë kësaj periudhe, por edhe për rolin dhe të drejtat që ajo gëzonte si në familje ashtu edhe në shoqëri. Në këtë kontekst, të vetmet burime që hedhin dritë në këtë çështje mund të konsiderohen dokumentet që gjenden pranë Arkivit Qendror të Shtetit. Kështu, vendimet e regjistrave të gjykatave të periudhës osmane japin të dhëna të rëndësishme për sa i përket jetës, aktivitetit dhe të drejtave të gruas shqiptare gjatë periudhës në fjalë. Pjesa më e madhe e regjistrave u përket shekujve XVII, XVIII dhe XIX, të cilat mbartin të dhëna të mjaftueshme në lidhje me shoqërinë shqiptare gjatë kësaj periudhe. Kështu, në bazë të të dhënave arkivore të gjetura është e mundur që aktivitetin dhe të drejtat e gruas gjatë kësaj periudhe t'i ndajmë në dy kategori: në familje dhe në jetën shoqërore.

Të drejtat e gruas në familje: Familja përbën institucionin bërthamë të shoqërisë dhe në traditën shqiptare ajo zë një vend shumë të veçantë. Duke u

bazuar në ligjin islam, mund të thuhet se edhe shteti osman i kushtoi një vëmendje të veçantë familjes duke i dhënë asaj të drejta të garantuara nga vetë institucionet perandorake.

Në rastin e gruas, ligji islam dhe për pasojë dhe ai osman i dhanë të drejta që për kohën përbënin një përparim të konsiderueshëm. Kështu, njëra ndër të drejtat themelore që i jepej femrës ishte ajo e trashëgimisë. Si mashkulli, ashtu edhe femra kishte të drejtën e pasurisë së trashëguar dhe e menaxhonte atë sipas dëshirës së saj. Ajo gëzonte të drejtën e trashëguarit gjysmën e pjesës së mashkullit me të cilin kishte afërsi të barabartë farefisnore.

Në regjistrat e gjykatave janë të shumta aktet e trashëgimisë në të cilat theksohet që ndër përfituesit e pasurive të lëna ishin edhe femrat. Për shembull, në një dokument të vitit 1701 tregohet se zotëria me emrin Xhaferr nga Mallakstra, një funksionar i lartë në Perandorinë Osmane ishte vrarë në betejën e Nishit dhe pasuria e tij trashëgohet nga e shoqja zonja Aishe, dy djemtë Aliu dhe Ahmeti dhe vajza Hanemeja. Po në kuadër të trashëgimisë, duhet theksuar se e drejta e përfitimit nuk ishte e njëjtë si për mashkullin ashtu edhe për femrën dhe varionte sipas rasteve dhe dispozitave që ligji islam kishte për rastet e veçanta.

Për shembull, kur një burrë vdiste dhe si trashëgimtare kishte vetëm gruan e tij, ajo kishte të drejtën të merrte vetëm një katërtën e pasurisë së lënë, ndërsa pjesa tjetër i kalonte thesarit të shtetit.

Në raste problemesh në lidhje me çështjet e trashëgimisë, gruaja kishte të drejtë të ankohej dhe të kërkonte drejtësi në instanca zyrtare siç ishte gjykata. Madje, në lidhje me këtë aspekt, në regjistrat e gjykatës së Sheriatit të Beratit vërehet një rast të vitit 1702, që tregon më së miri mënyrën se si gruaja e kërkonte dhe e mbronte trashëgiminë që i kishte mbetur. Sipas këtij dokumenti, gruaja me emrin Emine, e shoqja e Ahmet Beut kishte problem me trashëgiminë e mbetur nga i shoqi që i kishte vdekur, sepse vjehrra e saj Azizeja kishte vënë dorë mbi këtë pasuri dhe gjithashtu ushtronte edhe dhunë mbi nusen. Meqë çështja nuk është zgjidhur në instancat përkatëse, mësohet se ky ankim ka vajtur deri te Kadiasqeri i Rumelisë, i cili me anë të dokumentit në fjalë i shkruan kadiut të Beratit për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Rasti i sipërcituar tregon që gjatë periudhës në fjalë gruaja kishte të drejtë të hapte çështje gjyqësore dhe të kërkonte në mënyrë legale të gjitha të drejtat që i njihje asaj ligji i kohës.

Një tjetër të drejtë që gëzonte

gruaja shqiptare gjatë shekujve në fjalë konsistonte dhe në aktet e fejesës dhe të martesës. Sipas kësaj, ajo kishte të drejtën e aprovimit ose jo të fejesës ose martesës me kandidatin që i propozohej. Në regjistrat e gjykatave kemi shembuj të shumtë të vajzave apo vejuhave të cilat janë paraqitur përpara gjykatës dhe kanë kërkuar “të mos u lidhet kurorë pa praninë e tyre”. Gjithashtu, ka shumë dokumente dhe studime të cilat tregojnë që këtë të drejtë e gëzonin edhe gratë e besimeve të tjera, si në gjeografinë shqiptare ashtu edhe në pjesë të ndryshme të Perandorisë.

Për t'u vlerësuar është fakti që jo vetëm femrat që jetonin në zonat urbane ishin kaq të lira në këtë aspekt, por edhe ato që jetonin në zonat rurale ndërmerrnin nisma të tilla. Për shembull, në një dokument të vitit 1695, vajza me emrin Rabie, e bija e Mahmutit nga katundi Breshtan i Beratit, paraqitet te gjykatësi dhe kërkon të mos i lidhet kurorë pa qenë ajo e pranishme.

Një dokument tjetër tregon për të krishterën e quajtur Saveta, e bija e Thanasit nga fshati Perondija, e cila paraqitet në gjykatë dhe kërkon të mos i lidhet kurorë pa lejen e saj dhe pa qenë ajo e pranishme, edhe nëse paraqiten të afërm të saj për ta martuar atë.

Në kuadër të aktit të fejesës dhe martesës, duhet theksuar se ligji



islam urdhëron pagesën e një shume parash, dhurimin e një pasurie, prone ose diçka të ngjashme që dhëndri ia dhuronte nuses para martesës (mehr). Shuma e paguar varionte sipas shtresës ekonomike e sociale të cilës i përkisnin të dy kandidatët dhe vlefte e premtuar në shumicën e rasteve shënohej në dokumentin e kurorëzimit. Ky rregull është aplikuar në Perandorinë Osmane e si pasojë edhe në gjeografinë shqiptare. Në regjistrat e gjykatave hasim raste edhe në lidhje me këtë temë. Për shembull, në një dokument të vitit 1606, në gjykatën e qytetit të Elbasanit një grua paraqitet në gjykatë duke paditur të shoqin i cili i kishte premtuar asaj para martesës një ferexhe (mbulesë e gruas myslimane) si dhuratë e më pas nuk ia kishte dhuruar. Me anë të pagesës apo dhurimit të mehrit, mendohej se femra kishte një siguri financiare e cila mbetej e saj gjatë martesës dhe që ajo kishte të drejtë ta menaxhonte sipas dëshirës dhe nevojave të veta. Në këtë kontekst, mund të thuhet se në arkiva gjenden me mijëra dokumente të këtij lloji. Një element tjetër në kuadrin e të drejtave të gruas brenda familjes është dhe çështja e divorcit. Në raste mosmarrëveshjeje ose problemeve të ndryshme të rëndësishme brenda familjes të cilat nuk mund të zgjidheshin me anë të ndërmjetësimeve, ajo adresohet në gjykatë për të kërkuar divorcin bashkë me të drejtat që i takonin sipas ligjit. Nëse gjykata vendoste për ndarjen e kurorës, gruaja kishte të drejtën e përfitimit të pjesës së pasurisë nga i shoqi që i jepte

gjykata asaj (nafaka). Shuma e paguar në rastet e divorcit varionte sipas pasurisë që posedonte familja dhe pagesa konsistonte në para e edhe në elementë materialë. Për shembull, në një rast divorci të vitit 1695 në qytetin e Beratit, gruaja me emër Fatime përfiton nga gjykata si nafaka 2000 akçe, gjashtë okë vaj dhe sende të tjera. Por, ka dhe dokumente të tjera që tregojnë për raste kur gruaja hiqte dorë me dëshirën e saj nga të drejtat që i takonin nga divorci, siç është rasti i gruas me emër Sulltane e cila deklaronte se heq dorë nga përfitimet që i jepte asaj gjykata nga shkurorëzimi me Ahmet Hasanin. Një aspekt tjetër në lidhje me të drejtat e gruas në jetën bashkëshortore, por edhe në atë brenda familjes, është dhe çështja e administrimit të pasurisë së trashëguar. Studimet e kryera të bazuara në dokumentet e kohës, tregojnë se gruaja kishte të drejtë të menaxhonte pasurinë dhe të ardhurat e saj të trashëguara nga familja e vet, të dhuruara apo fituara gjatë periudhës së martesës. Pra, brenda jetës bashkëshortore gruaja dhe burri e kishin pasurinë e ndarë, aspekt i pranuar dhe mbrojtur ligjërisht. Kështu, mbi pasurinë apo pronën që ajo posedonte mund të kryente veprime në mënyrë të pavarur, si shitje, investime, donacione, mund të jepte kredi, madje ka raste kur i jepte hua edhe bashkëshortit. Në arkiva hasen dokumente të shumta për raste ku gratë e menaxhonin pasurinë e vet, e shisnin ose e dhuronin atë, madje në raste mosmarrëveshjeje edhe me pjesëtarët e familjes ajo kishte të

drejtë ta çonte çështjen në gjykatë. Kështu, një grua nga Fanica e Beratit shet shtëpinë e saj bashkë me vreshtin për 4000 akçe, ndërsa një grua tjetër e dhuron shtëpinë e saj. Një zonjë tjetër me emrin Hanife nga lagja Tabakhane e Elbasanit deklaronte se shet shtëpinë bashkë me oborr për shumën e 3700 akçeve. Gjithashtu, ka edhe raste të tjera kur gruaja ia shet ose ia dhuron bashkëshortit të saj pronën që ajo posedon. Për shembull, në një dokument të vitit 1703, mësohet se gruaja e quajtur Rabije nga një fshat i Beratit i shet të shoqit të saj një shtëpi. Ndërsa, në një dokument tjetër të vitit 1701, gruaja me emrin Fatime nga lagja Murat Çelebi e të njëjtit qytet është paraqitur në gjykatë dhe ka deklaruar se ia fal të gjithë pasurinë e saj të shoqit, Hysen Beut.

Roli i gruas në jetën shoqërore: Dokumentet dhe studimet e bëra në lidhje me periudhën në fjalë tregojnë se përveç ambientit familjar, femra ishte e angazhuar edhe në jetën shoqërore. Ato i gjejmë të punësuar në mjedise të ndryshme tregtare, por edhe drejtuese të vetë punës së vet. Pra, atyre u jepej e drejta e ushtrimit në mënyrë të pavarur të zejtit që ushtronte (testir). Për sa i përket punësimit, studiuesi Zija Shkodra ka theksuar se shumica e femrave ishin angazhuar në zeje të ndryshme me karakter shtëpiak. Ky fenomen vërehet më shumë në qendrat urbane, siç mund të përmenden qytetet shqiptare të kohës si Elbasani, Berati, Shkodra, Prizreni, Shkupi etj. Kështu, në studimet dhe dokumentet arkivore vërehet se gra të ndryshme shqiptare të besimeve të ndryshme kanë qenë të punësuar në korporata të ndryshme, si në pëlhura, gëzofe, esenca të ndryshme etj. Veçanërisht në qytetin e Elbasanit vërehen shumë dokumente që tregojnë për gra të cilat kanë fituar të drejtën e ushtrimit në mënyrë të pavarur të zanatit që ato zotëronin, ose kanë trashëguar zanatin që mund të ketë patur prindi i vet. Vlen të theksohet që një pjesë e mirë e këtyre grave vërehet që u përkasin edhe besimeve të tjera, pra jomyslimane. Një ndër fushat më të rëndësishme në të cilën ishin organizuar gratë gjatë shek. XVII-XIX ishin edhe vakëfet. Kishte disa arsye që i shtynin gratë të angazhoheshin në institucionet e vakëfeve. Së pari, duke patur parasysh jetën e gruas gjatë kësaj periudhe dhe faktin që ajo nuk lëvizte shumë jashtë ambienteve familjare, vakëfet ishin institucione që nuk kërkonin daljen në terren. Së dyti, ato ishin më aktive në kryerjen e aktiviteteve të bamirësisë. Deri sot nuk janë bërë studime të mirëfillta në lidhje me numrin e grave të


angazhuara në vakëfe në rang perandorak, por studimet e bëra tregojnë që në një pjesë të mirë të zonave urbane ato janë marrë më shumë se burrat në këto aktivitete.

Në lidhje me Shqipërinë, nuk ka studime që tregojnë numrin e grave të angazhuara në institucionet e bamirësisë, siç ishin vakëfet (fondacionet). Por, dokumentet arkivore dhe regjistrat gjykatave tregojnë për një numër të konsiderueshëm grash, të cilat kishin ndërtuar vakëfe, kishin dhënë donacione apo kishin punuar edhe vetë në këto institucione. Madje, kemi edhe raste kur gruan e shohim si administratore (mutevelli) vakëfi, aspekt i cili vërehet rrallë në Perandorinë Osmane ku shumicën dërrmuese të drejtuesve të vakëfeve e përbënin meshkujt. Konkretisht, në një dokument të vitit 1703 bëhet fjalë për një zonjë të quajtur Kadrije, e cila emërohet administratore e një vakëfi të një xhamie në qytetin e Beratit. Po ashtu, dokumentet tregojnë edhe për zonjën Rukije në qytetin e Elbasanit e cila është kujdestarja e vakëfit të saj. Në kuadër të kontributit dhe angazhimit të gruas në jetën shoqërore shqiptare gjatë periudhës së sundimit osman, vlen të përmendet dhe aktivizimi i tyre në përmirësimin e infrastrukturës së qyteteve. Ky angazhim gjithashtu duhet trajtuar në kuadër të vakëfeve apo veprave me karakter bamirësie të cilat u përmenden më sipër. Ka shumë dokumente dhe të dhëna që tregojnë për ndërtimin e çezmave, urave, shkollave, kervansarajeve dhe institucioneve të ngjashme nga ana e grave. Studiuesit shprehin se gjatë shek. XV-XIX ka shumë ura siç mund të përmendet ajo e Zonjës në

Labovë, e Cines në Rrëzomë, e Vashës në Gur të Bardhë etj., ndërtimi i të cilave është financuar nga gra të ndryshme.

Përfundim: Siç u pa edhe më sipër, në këtë studim krijohet një panoramë e gjendjes së gruas shqiptare gjatë periudhës së Mesjetës, duke u përqendruar më së shumti në shek. XVII-XVIII. Me këtë rast janë përdorur çështjet e shqyrtuara dhe vendimet që kanë dalë në lidhje me to në regjistrat e gjykatave të sheriatit të qyteteve të ndryshme. Dokumentet arkivore tregojnë që edhe pse jetonte në një periudhë të vështirë, gruaja shqiptare gëzonte disa të drejta themelore, si e drejta e të trashëguarit, e fejesës dhe martesës, e drejta e pasurisë dhe e menaxhimit të saj, të drejtën e aplikimit në gjykata për të drejtat e saj etj. Gjithashtu, dokumentet tregojnë që ajo ishte e angazhuar edhe jashtë shtëpisë, si të marrurit me profesione të ndryshme, ashtu edhe aktivizimi në dobi të shoqërisë me anë të vakëfeve apo institucioneve të ngjashme. Të dhënat e mësipërme tregojnë që gruaja shqiptare gjatë kësaj periudhe gëzoi disa të drejta që për shoqërinë e kohës ishin një arritje e konsiderueshme. Por, përveç të drejtave të përmendura, gruaja shqiptare haste dhe probleme e vështirësi që kishin lidhje me kushtet ekonomike të kohës, vajtjen në luftëra të burrave etj. Një fenomen tjetër negativ në lidhje me gruan i cili është evident duke nisur që nga fundi i shek. XVIII, është dhe dhënia e vajzave në moshë të mitur si shërbëtoresh pranë familjeve të pasura për shuma qesharake. Këto dhe shumë elementë nuk janë përfshirë në këtë punim.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot luhet ndeshja e Superkupës, Kosovë - Diasporë

PRISHTINË, 17 TETOR - Në Kampin Nacional në Hajvali, organizuar nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), sot (e mërkurë) do të zhvillohet

ndeshja ndërmjet fituesit të Kupës së Kosovës, FC Prishtina dhe fituesit të Kupës së Kosovës për Gjermani, FC Kastrioti Stukenbrock. Kjo

ndeshje do të zhvillohet nga ora 13:00. Ky aktivitet është tradicional tash e disa vjet dhe ka për synim t'i afrojë bashkatdhetarët

tanë me vendlindjen, njëherësh ta promovojë pasionin dhe talentin e futbollit të bashkatdhetarëve tanë në diasporë.



Shqipëria ka gjasa 99 për qind të shkojë në 'Euro 2024', Kosova 1 për qind të mundësive

PRISHTINË, 17 TETOR - Kombëtarja shqiptare shihet me mundësi të mëdha për t'u kualifikuar në "Euro 2024" pas fitores ndaj Republikës Çeke dhe pas barazimit të fundit të Moldavisë me Poloninë.

Tomislav Globan, profesor i ekonomisë sportive në Universitetin e Zagrebit, i cili merret me të dhëna sportive, me statistika e me analiza, në rrjetet sociale i ka publikuar projeksionet statistikore të "Euro 2024", me tabela dhe përqindje të gjasave të kombëtareve për t'u kualifikuar dhe se në cilat vazo mund të përfundojnë ato. Globan e ka vënë Shqipërinë në një pozicion mjaft të favorshëm me 99 për qind të mundësive për të shkuar në Evropian dhe me mundësi prej 89-përqindësh që të përfundojë në vazon e dytë gjatë shortit të "Euro 2024", i cili do të hidhet në dhjetor të këtij viti. Kështu, Shqipëria ka mundësi të përfundojë në një grup të kënaqshëm, me një kombëtare më të fortë, që do të



jetë në vazon e parë, dhe me dy kombëtare më mesatare. E nëse ekipi i Sylvinhos i fiton dy ndeshjet e nëntorit dhe

eventualisht ndonjë kombëtare e madhe dështon, atëherë Shqipëria do të jetë bartëse e grupit dhe mundësitë për të

ndodhur kjo janë veç pesë për qind. Për dallim prej Shqipërisë, Kosova shihet thujt pa gjasa për të shkuar në Gjermani vitin

tjetër. Sipas ekspertit kroat, "Dardanët" i kanë veç 1 për qind të mundësive për t'u kualifikuar në Evropian.

Messi do ta fitojë Topin e Artë të Artë?



MADRID, 17 TETOR - Lionel Messi do ta fitojë Topin e Artë numër tetë. Mediumi spanjoll "Sport" ka raportuar se ylli argjentinas do ta marrë çmimin prestigjioz në ceremoninë që do të mbahet nga revista franceze "France Football" në Paris më 30 tetor. Kampioni i Botës e ka fituar shtatë herë këtë trofe, një rekord absolut, ndërsa këtë muaj mund ta forcojë edhe më shumë rekordin, që duket të jetë i paarritshëm. Messi duket se e ka mposhtur rivalin kryesor për këtë çmim

sivjet, Erling Haalandin, i cili, po ashtu, e pati një vit fantastik si në nivelin personal, pasi ka thyer shumë rekorde me 52 golat e tij, ashtu edhe në atë ekipor, pasi e ka fituar Ligën e Kampionëve dhe Premierligën me Manchester Cityn. Messi pritet ta fitojë Topin e Artë falë paraqitjeve të tij fenomenale në Kupën e Botës të cilën e fitoi me Argjentinën. Messi ka bërë paraqitje të mira edhe me Inter Miamin gjatë verës që shkoi, ndonëse në Amerikë luhet futboll i nivelit më të ulët.

Rivali i përhershëm i Messit, Cristiano Ronaldo, do të mbetet me pesë trofe të Topit të Artë pasi nuk është pjesë e rrethit të ngushtë të kandidatëve edhe pse mbrëmë është bërë golashënuesi më i mirë i vitit 2023 - deri tash me 40 gola. Një konkurrencën e femrave, një tjetër kampione e botës, Aitana Bonmati, e cila ishte lojtarja më e mirë e turneut të mbajtur në Australi dhe në Zelandën e Re, pritet ta fitojë Topin e Artë pasi shkëlqeu me Spanjën dhe me Barcelonën.

Albion Rrahmani përfundon me sukses operimin

Bukuresht, 17 tetor - Sulmuesi i Kosovës dhe i Rapid Bukureshtit, Albion Rrahmani, është operuar me sukses pas lëndimit të rëndë që e ka

pësuar javën e kaluar në ndeshjen e Kosovës kundër Andorrës. Klubi i Rrahmanit, Rapid Bukureshti, ka njoftuar se yllin

nga Kosova e ka operuar doktori Vlad Georgeanu. "Mentalisht ai është shumë i fortë dhe është i gatshëm për të nisur rrugën drejt kthimit në

fushë", ka njoftuar klubi nga Rumania. Albin Rrahmani ka lënduar nyjën e këmbës dhe pritet të mungojë rreth tre muaj.



| | | | | | | | |
|---|---------------|------------|--------------|--|--|--|--|
|  | | | | REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE | | | |
| KATEGORIA/DOKUMENTI: DATUM/PRILIDHJE/OSTAVLJE: EMËRTESUESI/SUBJECTI: | | | | 10/2023 | | | |
| Klasif. Org. | Shif. Klasif. | Nr./ Prot. | Nr. faqeve | | | | |
| Org. Jedin | Klasif. Kod | Br. Prot. | Br. Stranica | | | | |
| 07/12 | 112 | 1869 | 1 | | | | |

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo
 Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
 Nacionalna Kancelarija Revizije
 National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 24.08.2023, për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri

Numri i referencës: AJAFP/ZKA/09-08/23

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 1866 të datës 17.10.2023

Prishtinë, 17.10.2023

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

[Signature]

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 24.08.2023. godine, za radno mesto:

I. Položaj: Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju uskladenosti


Broj reference: AJAFP/ZKA/09-08/23

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 1866 od datuma 17.10.2023

Priština, 17.10.2023

Departman za upravljanje ljudskim resursima

[Signature]



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Era Pireva shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Filologjik dega Gazetari, Prishtinë.

- Ruzhdi Rashiti shpall të pavlefshëm certifikatën e aftësisimit profesional me numër protokollit: 5438/19 e lëshuar me 08.10.2019 në Ferizaj, drejtimi: Murator/Ndërtimtar.

- Eslem Gashi shpall te pavlefshme deftesat, certifikatën , diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Munir Anadolu shpall te pavlefshme deftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Nuridin Isljami shpall te pavlefshme 4 deftesat dhe diplomën Q.K."11 Marsi " Prizren.

- Taulant Gashi shpall te pavlefshme 4 deftesat Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Nuhi Rexhepi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Hami Ramadan Bajraliu shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit të Prishtinës, drejtimi Ekonomik me nr. 742.

- Anita Uka shpall të pavlefshme deftesat e shkollës fillore nga kl. parë deri të nëntën të shkollës "Nazim Gafurri" Prishtinë.

- Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 deftesat shme " Ymer Prizreni "Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme deftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.

- AGRON PEÇI, shpall te pavlefshme deftesën 1-8 SHFMU "MUHARREM BEKTESHI".

- KENAN JONUZI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme te larte "ARKITEKT SINANI".

- BEKIM PEÇI, shpall te pavlefshme deftesat e shkollës fillore "ISMAIL QEMALI".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

